

VENDIM
Nr. 367, datë 18.5.2016

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT TE BASHKIA
LIBRAZH, TË PRONËS ME NUMËR PASURIE 7/19, NË ZONËN KADASTRALE 2446
LIBRAZH, SI DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 359, DATË 5.6.2003, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË
PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE,
TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI SHËRBIMIT INFORMATIV
SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, shkronja “a”, 5, 7, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Shërbimi Informativ i Shtetit te Bashkia Librazhd, të pronës me numër pasurie 7/19, të ndodhur në zonën kadastrale 2446 Librazhd, me sipërfaqe truall 1552 (një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) m² dhe ndërtesë 371 (treqind e shtatëdhjetë e një) m², sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për sistemimin me ambiente pune të administratës së Bashkisë Librazhd.

2. Në listën e inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 359, datë 5.6.2003, të Këshillit të Ministrave, hiqet prona me numër pasurie 7/19, e ndodhur në zonën kadastrale 2446 Librazhd, me sipërfaqe truall 1552 (një mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) m² dhe ndërtesë 371 (treqind e shtatëdhjetë e një) m².

3. Bashkisë Librazhd i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Punëve të Brendshme, kryetari i Bashkisë Librazhd, kryetari i Shërbimit Informativ të Shtetit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTESHME SHETERORE
(Per inventarin e pronave te vecanta)

Institucioni i Pushtetit Qendror _____

Bashkia/Komuna : LIBRAZH

Fusha e perdorimit te Prones : Administrative

Identifikoi Veli Dashi (Specialist)

Supervizoi Mirela Biba (Specialist)

Aprovoi Kastriot Gurra Kryetar i Bashkise Librazhd

Nr.	A			B			C			
	Zona Kadastrale & Indeksi i hartes	Nr. pasurise	Lloji i pasurise	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga sip Totale sa ndertesa (m2)	Funksioni per te cilen perdoret Prona	Institucioni Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni Enti perd. Statusi juridik perdorimit	Te dhena tjera (Shenime vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	2446 LB-E-3	7/19	Truall	Prokuroria e rrethit e Librazhd dhe siperfaqe funksionale	1552	371	Aktualisht nuk perdoret	Sherbimi Informativ Shtetror	S'ka perdorim	Godina eshte 2kt, jashte funksionit, pas kalimit te aktivitetit ne qarkun Elbasan

